



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 7-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 26.07.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Shkelzen Hajdini, DSH
3. Imri Smetishti, DPUMM

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë, me kohë të cilën e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 6-të e KPF-së.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Qershor 2022.
3. Propozim Vendim për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan.
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit komunal për rishqyrtimin e emërimeve dhe riemërimeve të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në teritorin e Komunës së Lipjanit.

5. Propozim Vendim për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022-2025.
6. Propozim Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 15Nr.463-76605 të datës 26.12.2018.

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 6 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj Kryesuesi tha se pikën e 3-të a jeni që të kalojnë direkt në Kuvend?

Me të gjitha votat, 6 për, u aprovua propozimi.

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 6-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 6-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

III

Propozim Vendim për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdini drejtor i DSH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se është një temë e ndishme dhe për këtë duhet të bëhet një debat i gjerë dhe do të ishte mirë që të ishin më shumë propozime dhe të zgjidhet ai që është më i miri. Ne nuk kemi asgjë kundër doktorit e as familjes së tij por po mendojë që ky emër po bëhet politikisht. Është mirë që të shikohet historia e secilit dhe mos të lejojmë që dikush të hidhërohet.

Fitim Shala, tha se ky propozim ka ardh nga stafi i personelit shëndetësor në Magurë ku janë marrë nënshkrimet pastaj nënshkrimet janë kërkuar edhe në QKMF në Lipjan për vendosjen e emrit të Dr.Mehdi Zejnullahu.

Arsim Jashari, tha se aq sa kam informata unë nënshkrimet janë marrë QMF në Magurë dhe ato janë marrë edhe nga bashkëshortja e dr. Mehdis.

Daut Azemi, tha se nënshkrimet kanë filluar nga personeli i QMF-së në Magurë për vendosjen e emrit të QKMF-së në Lipjan të dr. Mehdi Zejnullahu dhe jo siq po flitet që janë marrë për QMF-në në Magurë dhe secili që e ka dhënë nënshkrimin ka qenë i vetëdijshëm se qka do të nënshkruaj.

Alban Salihu, tha se ardhja e këtij propozimi është pak e çuditshme pasi që ky ka qenë një mjek i zakonshëm dhe nuk ka pasur diqka të veçant dhe si emër nuk është unifikuës për QKMF në Lipjan . Ne si grup i VV-së nuk do ta përkrahim këtë propozim.

Shkelzen Hajdini, tha se ne e kemi obligim me I respektu proceduart ligjore dhe si ekzekutiv e kemi sjell këtë pikë në kuvend pasi që ka qenë një peticion i personelit shëndetësor të QKMF-së në Lipjan me mbi 170 nënshkrime ndërsa ju si kuvend jeni ata që do të votoni ose jo .

Arsim Jashari, tha se këto do të mbestin në histori dhe unë nuk do të lejojë që kjo të jetë në histori pasi që do të bëjmë një gabim dhe QKMF nuk është vetëm e personelit shëndetësor por e të gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Alban Salihu, tha se ju si drejtori po tentoni ta heqni përgjegjësin nga vetja dhe ende nuk dihet se cili është qëndrimi juaj. Aq sapo shihet ky emër nuk është unfikues për të gjithë edhe pse unë nuk kam asgjë personale me familjen e doktorrit apo me doktorin por do të duhej të ishte mirë sikur të kishte më shumë propozime.

Shkelzen Hajdini, tha se qëndrimi ynë dihet se si do të jetë dhe secili e bartë përgjegjësin e vetë për votën e tij për apo kundër.

Arsim Jashari, tha se ne jemi të zgjedhurit të popullit dhe votojmë sipas qëndrimit tonë por nesër dikush do të thotë që ky ka qenë shok i kryetarit dhe pjesë e LDK-së dhe për atë i është vendosur

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 5 vota për, dhe 2 kundër vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për formimin e komisionit komunal për rishqyrtimin e emërimeve dhe riemërimeve të rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike në teritorin e Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, drejtor i DPUMM-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se edhe kjo pikë lidhet me pikën paraprak dhe si duket do të jetë një çështje shumë e ndijshme.

Daut Azemi, tha se është një pikë e ndijshme por duhet të zgjidhet.

Imri Semetishti, tha se janë disa ankesa të qytetarëve të cilat janë bërë të emërtimit të disa rrugëve duhet t'i zgjedhim po ashtu është edhe kërkes e Agjensionit Kadastral të Kosovës.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Vendim për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022-2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdini, drejtor i DSH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 15Nr.463-76605 të datës 26.12.2018.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Smetishti, drejtor i DPUMM-, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Alban Salihu, tha se a do t'i ndjekin procedurat e lejes në bazë të hartave zonale të komunës.

Imri Smetishti, po në bazë të hartave zonale të komunës dhe kushteve tjera do të pajisen me leje ndërtimore.

Arsim Jashari, nëse edhe për 36 muaj nuk e përfundon punën çka do të bëhet?

Imri Smetishti, do të veprojmë sipas asaj që e kemi cekur në vendim do t'i merret prona.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Propozim Vendim për miratimin e Planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2022-2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:50

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi